РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА - АРХЕОЛОШКИ МУЗЕЈ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - СКОПЈЕ
INSTITUCIONI NACIONAL - MUZEU ARKEOLOGJIK
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - SHKUP
Бр.-Nr. 04-1118/2
18-11 2026 год.-viti
СКОПЈЕ-SHKUP

**НУ Национален Археолошки музеј / IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar**
Кеј Димитар Влахов бб – Скопје / Kej Dimitar Vlahov pn - Shkup
тел. ++389 2 3233999
e-mail: contact@amm.org.mk

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 110/2019 dhe nr. 74/25), nenit 77-a, paragrafët 1, 2 dhe 5, nenit 77-c, paragrafi 1, nenit 77-ç, nenit 77-d dhe nenit 77-dh të Ligjit për Kulturën (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/7, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18), nenit 20-ç të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 143/19 dhe 14/20), si dhe në përputhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, nr. 01-509/1, datë 20.08.2020, si dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-49/1, datë 21.01.2021, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-163/1, datë 16.02.2021, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-424/1, datë 28.05.2021, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-618/1, datë 18.08.2021, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-811/1, datë 30.11.2021, Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.03-498/3, datë 27.06.2022, dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-775/1, datë 02.11.2022, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-566/1, datë 01.08.2023, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-1067/1, datë 20.12.2024, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-559/1, datë 05.06.2025, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të

punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-179/1, datë 12.02.2026, dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-636/1, datë 20.05.2026, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-737/1, datë 01.07.2026, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-807/1, datë 22.07.2026, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-814/1, datë 24.07.2026, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.01-948/1, datë 14.09.2026, dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr. 01-1080/1, datë 03.11.2026, Rregulloren për elementet e detyrueshme të shpalljes publike për plotësimin e një vendi pune në sektorin publik përmes punësimit dhe të formularit të aplikimit për punësim, si dhe për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rreme gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 34/15), Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe të formularit të aplikimit për punësim, mënyrën e realizimit të përzgjedhjes, mënyrën e realizimit të intervistës, si dhe mënyrën e pikëzimit në varësi të kategorisë dhe nivelit të vendit të punës për të cilin është publikuar shpallja publike në Institucionin Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar, nr.02-677/5, datë 18.07.2025, dhe Njoftimin për sigurimin e mjeteve financiare nga Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 19-8226/2, datë 12.11.2026, Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE nr.06/2026**

Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar ka nevojë për punësimin e 1 (një) personi, ofrues të shërbimeve, me kohëzgjatje të pacaktuar të marrëdhënies së punës, në pozitat e mëposhtme:

**1. Bashkëpunëtor tjetër profesional në kulturë**, me kod të vendit të punës KUL 03 04 G02 012, në Sektorin për Punë Profesionale, Njësia për Dokumentacion Muzeor dhe Punë Profesionale-Teknike, numri i realizuesve 1 (një).

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës madhor;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Me aktgjykim të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e veçanta:**

- Për vendin e punës Bashkëpunëtor tjetër profesional në kulturë, të ketë fituar së paku 240 ECTS ose të ketë të përfunduar shkallën VII/1 në fushën e shkencave shoqërore, shkencave sociologjike (sociologji), ose të ketë të përfunduar arsimin e mesëm;
- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion.

**Kushtet e tjera të veçanta:**

- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohuri aktive të njërës nga tri gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Kandidatët, së bashku me aplikimin, duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme (në origjinal ose kopje të vërtetuara te noteri) për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta:

- Vërtetim për shtetësi;
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Vërtetim mjekësor (jo më i vjetër se gjashtë muaj);
- Vërtetim/Certifikatë se me aktgjykim të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më i vjetër se gjashtë muaj);
- Dëshmi – Diplomë/Certifikatë për përfundimin e arsimit përkatës.

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim (të përgjithshme dhe të veçanta).

**Orari i punës për vendin e punës Bashkëpunëtor tjetër profesional në kulturë:**

Ditët e punës: nga e hëna deri të premten.

Orari javor i punës: 40 orë.

Orari ditor i punës: nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

**Shuma neto e pagës:**

Shuma mujore neto e pagës për Bashkëpunëtor tjetër profesional në kulturë është 54.395,00 denarë.

**Afati për dorëzimin e aplikimeve:**

Afati për dorëzimin e aplikimeve për punësim, së bashku me dokumentet e nevojshme, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke filluar nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin e përditshëm dhe në faqen e internetit të institucionit www.amm.org.mk. Kushtet e përcaktuara në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Aplikimi për shpalljen mund të merret në arkivin e IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, me seli në Kej „Dimitar Vllahov" p.n. 1000 Shkup, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:00, ose të shkarkohet nga faqja e internetit www.amm.org.mk.

Kandidatët janë të detyruar që aplikimin ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë të saktë dhe me të dhëna të sakta.

**Mënyra e dorëzimit të aplikimeve:**

Aplikimin dhe dokumentacionin e kompletuar kandidatët mund ta dorëzojnë me postë, në zarf të mbyllur, me shënimin „Për shpalljen publike për punësim nr.06/2026 për vendin e punës Bashkëpunëtor tjetër profesional në kulturë", në adresën: Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar, Keji „Dimitar Vllahov" p.n. 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së

Veriut, ose në arkivin e IN Muzeu Arkeologjik Kombëtar, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:00, përfshirë edhe ditën e fundit të afatit.

Aplikimet dhe dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe ato jo të kompletuara nuk do të shqyrtohen.

**Informacion për zhvillimin e procedurës:**

Përzgjedhja administrative për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave dhe dëshmive të dorëzuara në shpalljen publike, si dhe zhvillimi i intervistës, gjatë së cilës përmes pyetjeve do të verifikohen kompetencat e nevojshme për kategorinë dhe nivelin të cilit i përket vendi i punës, do të kryhen nga Komisioni kompetent i formuar për zhvillimin e procedurës së punësimit.

Kandidatët e paraqitur do të njoftohen me kohë për datën, orën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

**Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik Kombëtar**

**Drejtor**

Magdalena Manaskova